

DAXOROL Pulverkleber DX-5

■ **Vendet e përdorimit:** - Llaç ngjitës hidraulik lidhës për sistemet izoluese të Daxorol-it për ngjitjen e pllakave izoluese nga stiropori , tervoli dhe për realizimin e shtresës së armuar suvatuese.



■ **Baza e materialit:**

Rërë, çimento, lëndë të lehta mbushëse dhe shtesa për përmirësimin e vetive përpunuese.

■ **Vetitë:**

Suvatim fleksibël për shtresat vijuese të suvave.

■ **Kushtet e përpunimit:**

Gjatë përpunimit temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5°C. Deri te tharja e plotë duhet të mbrohet nga ngrica dhe rrezatimi direkt i diellit.

■ **Përgatitja e bazamentit:**

Bazamentet të jenë të pastra, të afta për bartje dhe pa mbetje vajrash dhe yndyrash. Sipërfaqet nga rëra dhe sipërfaqet thithëse paraprakisht duhet të lyhen me Daxorol Unigrund.

■ **Përgatitja:**

Thes 25 kg DX 5 G Pulverkleber përzihet me 7,5 litra ujë deri në formimin e një llaçi pa toptha. Pas një kohe prej 5 min. masa e fituar të përzihet edhe një herë me mikser.

■ **Përdorimi:**

DX 5 G Pulverkleber merret me një mistri rrafshuese adekuate nga rostfraji dhe me te nejtën shtrihet dhe rrafshohet. Trashësia minimale e shtresës: 0.5-0.8 cm. Perzierja me materiale tjera nuk është e lejuar.

■ **Udhëzime për rreziqe:**

Përmban çimento/hidrat gëlqeror Xi irritues. Të mbrohen lëkura dhe sytë.

■ **Deponimi:**

Të deponohet në vend të thatë. Afati i përdorimit 12 muaj.

■ **Të dhëna teknike:**

Thes 25kg, ngjyrë hiri dhe e bardhë, madhësia e kokrrës 0-0,7 mm.

Harxhimi: ngjitje dhe armim rreth 7 kg/m².

Pastrimi i veglave të punës të bëhet me ujë.